



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Data: 18.05.2023

Nr: 79

Ora: 18:00

URDHËR

PËR

**EVIDENTIMIN E PUNONJËSVE TË KQZ, APO DHE TË TRETË TË TJERË TË KONTRAKTUAR ME
DETYRA PËR PËRGATITJEN E PAJISJVE ELEKTRONIKE TË IDENTIFIKIMIT (PEI) DHE
DORËZIMIN E TYRË NGA KQZ NË KQV DHE ANASJELLTAS, PËR ZGJEDHJET E DATËS 14 MAJ
2023**

Në mbështetje të neneve 14 dhe 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar

URDHËROJMË:

1. Të evidentohen të gjithë personat, anëtarë të stafit të përhershëm dhe të përkohshëm të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, apo të tjerë të kontraktuar, të cilët kanë patur detyra në lidhje me përgatitjen, si dhe me ruajtjen, transportimin dhe dorëzimin e Pajisjes Elektronike të Identifikimit (PEI) nga KQZ në KQV dhe anasjelltas.
2. Të evidentohen detyrat e gjithësecilit sa më sipër bazuar në përshkrimet e punës, apo në kontratën e rastit me KQZ.
3. Të ngarkuarit me zbatimin e këtij urdhri duhet të paraqesin një raport me shkrim tek Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve dhe Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve jo më vonë se data 1 Qershor 2023.
4. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Administrimit të Zgjedhjeve, Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme Rregullatore, Ekonomike dhe Mbështetëse, Drejtori i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtori i

Data: 18.05.2023 Nr:79
Ora: 18:00



Për evidentimin e punonjësve të KQZ, apo dhe të tretë të tjerë të kontraktuar me detyra për përgatitjen e pajisjeve elektronike të identifikimit (pei) dhe dorëzimin e tyre nga KQZ në KQV dhe anasjelltas, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023

Logjistikës dhe Digjitalizimit si dhe Shefi i Sektorit të Administrimit të të Dhënave Digjitale për zbatimin e këtij urdhri.

5. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

Nënkomisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Lealba PELINKU

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI

Data: 18.05.2023 Nr:79
Ora: 18:00



Për evidentimin e punonjësve të KQZ, apo dhe të tretë të tjerë të kontraktuar me detyra për përgatitjen e pajisjeve elektronike të identifikimit (pei) dhe dorëzimin e tyre nga KQZ në KQV dhe anasjelltas, për zgjedhjet e datës 14 maj 2023